

Rekomandime për frenimin e flukseve emigratore të parregullta

Përgatitur nga Ilir Gëdeshi dhe Armela Xhaho,
Ekspertë të çështjeve të migracionit

Ky dokument është hartuar në mbështetje të një cikli të dëgjësave publike me anëtarëve të komisioneve parlamentare në kuadër të projektit "Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve", zbatuar nga IDM, Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS) dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e qeverisë britanike.

KONTEKSTI

Shqipëria ka njohur që nga fillimi i tranzicionit pas-socialist një nga proceset migratore më të mëdha bashkëkohore në botë për sa u përket përmasave (si përqindje ndaj popullsisë aktuale) dhe intensitetit të migrimit ndërkombëtar. Sipas të dhënave të INSTAT-it, brenda tre dekadave, pra deri në 2020, vendi prodhoi një stok prej 1.68 milion emigrantësh, të barabartë me 59 për qind të popullsisë rezidente në Shqipëri.¹ Në botimin e saj periodik *Migration and Remittances Factbook*, Banka Botërore e Rendit Shqipërinë midis 20 vendeve të para në botë (vendi i 9 në 2011 dhe i 17 në 2016) për përmasat e emigrimit.²

Pavarësisht se procesi i migrimit ka qenë që nga fillimi i tranzicionit pas-socialist një proces dinamik, intensiteti dhe karakteristikat e tij kanë ndryshuar dekadë pas dekade. Gjatë dekadës së tij të parë emigrimi shqiptar ishte intensiv, spontan, i parregullt dhe përbëhej kryesisht nga meshkujt që kërkonin punë krahu, të cilën mund ta gjenin në ndërtim dhe bujqësi, kryesisht në dy vendet fqinje (Greqi, Itali). Në dekadën e dytë vërehet një maturim i flukseve migratore, - kryesisht të rregullta, - bashkim familjar, integrim në vendin pritës dhe përmirësim i statusit të punësimit. Gjeografia e emigrimit u zgjerua në vende të tjera të Evropës dhe në Amerikën e Veriut. Ndërsa gjatë dekadës së tretë të migrimit shqiptar vërejmë një ndërthurje të emigrimit, rikthimit të emigrantëve dhe të imigrimit tranzit, ku emigrimi vazhdoi të ishte fluksi kryesor. Prosesi i emigrimit u intensifikua, u diversifikua (emigrim i rregullt dhe i parregullt, *brain drain (largimit të trurit)*, etj.) dhe vende të reja si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca, etj. iu bashkëngjitën vendeve tradicionale (Greqi, Itali) të emigrimit shqiptar. Ky emigrim kulmoi në 2015 kur rreth 67.000 shqiptarë kërkuan azil në vendet e BE, kryesisht në Gjermani.³ Gjatë kësaj dekade edhe procesi i kthimit të emigrantëve u intensifikua, duke kulmuar dy herë: në vitet 2010-2013, si rezultat i krizës ekonomike globale ku shumë emigrantë shqiptarë në Greqi dhe Itali humbën vendet e tyre të punës,⁴ dhe në vitet 2015-2017, si rezultat i kthimit të azil-kërkuesve të refuzuar, kryesisht nga Gjermania e Franca.⁵ Në të njëjtën kohë, një pjesë e vogël e flukseve të refugjatëve që kalonin tranzit nga vendet e Ballkanit Perëndimor për në vendet e BE, rrugëtoi nëpërmjet Shqipërisë.

Gjatë dekadës së tretë të migrimit shqiptar flukset e emigrantëve të parregullt janë përbërë kryesisht nga azil-kërkuesit. Sipas të dhënave të EASO-s, gjatë periudhës 2010 – 2019 më shumë se 194.000 qytetarë shqiptarë, kryesisht të rinj dhe me fëmijë, aplikuan për herë të parë për azil në vendet e Evropës.⁶ Në vitet në vazhdim intensiteti i kësaj forme të emigrimit, për shkak edhe të nivelit të lartë të refuzimeve nga vendet pritëse, është ulur, por fenomeni mbetet i pranishëm. Një pjesë e emigrantëve të parregullt përbëhet nga fëmijë të pashoqëruar nga prindërit, çka përbën edhe një nga plagët më të mëdha të migrimit shqiptar. Kështu, sipas të dhënave të EUROSTAT, gjatë periudhës 2012-2022, rreth 2.125 fëmijë të pashoqëruar nga Shqipëria kanë kërkuar azil në vendet e BE.⁷

1 INSTAT., (2020). Popullsia e Shqipërisë. Tirana: INSTAT.

2 World Bank., (2016). Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: The World Bank; World Bank., (2011) Migration and Remittances Factbook 2011. Washington DC: The World Bank.

3 Gëdeshi I., King R., (2022) Albanian Returned Asylum-Seekers: Failures, Successes and What Can Be Achieved in a Short Time. Journal of Balkan and Near Eastern Studies 24(3): 479-502.

4 INSTAT & IOM., (2014) Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2013. Tirana: INSTAT.

5 OECD., (2019) International Migration Outlook 2019, Paris, OECD.

6 European Asylum Support Office., (2019) Annual Report on the Situation of Asylum in the European Union, Valletta, EASO.

7 Eurostat, 2023. <https://bit.ly/3xw12i7>

Krahas migrantëve të parregullt dhe refugjatëve koncepti i migrantëve përfshin edhe kategori të tjera, si migrantët ekonomikë dhe *brain drain* (*largimit të trurit*). Një nga karakteristikat e migrimit shqiptar, sidomos në dekadën e tretë të tij, është migrimi i të rinjve më të arsimuar dhe të kualifikuar profesionalisht. Kështu, sipas studimit të Leitner 40 për qind e flukseve migratore gjatë periudhës 2011–2019 përbëheshin nga të rinj në të 20' me arsim universitar dhe 30 për qind nga të rinj në prag të 20' me arsim profesional.⁸

Një fenomen tjetër shqetësues është ri-emigrimi i të sapokthyerve/ riatdhesuarve nga emigracioni.⁹

Kthimi i fëmijëve azilkërkues në vendin e origjinës, jo gjithmonë është një histori suksesi pasi mungesa e perspektivës për të ardhmen dhe mungesa e askesit në shërbime cilësore, rrisin mundësitë që të kthyerit nga emigracioni të kërkojnë sërish azil në vendet e BE-së.¹⁰

Migrimi shqiptar vazhdon dhe sipas të gjitha gjasave do të vazhdojë me intensitet të lartë edhe gjatë dekadës së katërt të tij. Ky përfundim bazohet në statistikat e kufizuara për flukset e deritanishme dhe nga të dhënat e emigrimit potencial, të cilat tregojnë se synimi për të emigruar nga Shqipëria është i lartë.¹¹ Rrjedhimisht Shqipëria, megjithëse thuajse në mesin e dekadës së saj të katërt të migrimit ndërkombëtar, është ende larg përfundimit të tranzicionit të saj migrator.

SHKAQET E MIGRIMIT

Ekzistojnë shkaqe të ndryshme të migrimit, ku mund të përmendim faktorët ekonomikë, arsimorë, familjarë, shëndetësorë dhe perceptimin që kanë të rinjtë për perspektivën e tyre në Shqipëri.

Sidoqoftë faktorët ekonomikë, ku bëjnë pjesë përmirësimi i standardeve të jetesës, papunësia, pagat e ulëta dhe kushtet e punës, skema e sigurimeve sociale dhe borxhet, vazhdojnë të mbeten shtytësit kryesorë të migrimit shqiptar. Kështu, shkalla e papunësisë mes të rinjve të grup-moshës 15–24 vjeç (24.9 për qind në 2022) dhe masa e të rinjve të grup-moshës 15–29 vjeç që nuk janë as në punësim e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim (25.2 për qind në 2022) është ende e lartë.¹² Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale dhe të thella janë të ekspozuar ndaj varfërisë së madhe kronike dhe rrezikut të lartë të përjashtimit social për shkak të gjendjes së vazhdueshme të pafavorshme sociale dhe ekonomike, mungesës së mundësive të punësimit dhe izolimit total. Studimet e fundit për popullsinë në tërësi dhe për segmente të saj (azil-kërkuesit, emigrantët ekonomik, studentët, profesionistët, etj.) në veçanti tregojnë se faktorët

8 Leitner S., (2021) Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2011 and 2019: Results from a Cohort Approach. Vienna: Vienna Institute for International Economics, wiiw Working Paper 197.

9 Xhaho, A. and Caro, E. (2016). Returning and Re-Emigrating Gendered Trajectories of (Re) Integration from Greece. European Journal of Multidisciplinary Studies, 3(1), pp.171-180.

10 Xhaho, A. (2023). Report: Recommendations on the workflows of effective referral pathways and sustainable reintegration of Unaccompanied Albanian Minors. International Centre for Migration Policy Development. Brussels

11 King R., Gëdeshi I., (2020). New Trends in Potential Migration from Albania. Migration and Development 9(2): 131-151.

12 INSTAT., (2023) Shqipëria në shifra 2022. Tirana: INSTAT.

ekonomikë përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të gjithë faktorëve të migrimit.¹³ Kjo tregon se migrimi shqiptar edhe pse në dekadën e tij të katërt, ndonëse në një masë më të vogël, vazhdon të udhëhiqet nga faktorë ekonomikë.

Këto faktorë ekonomikë janë shumë më të rëndësishëm për azil-kërkuesit, një nga segmentet më të varfër të popullsisë shqiptare. Studimet tregojnë se thuhetse 2/3 e familjeve të tyre kanë një gjendje financiare të 'pamjaftueshme' ose 'fare e pamjaftueshme' për të përballuar nevojat e jetës së përditshme. Kjo buron nga papunësia, të ardhurat e ulëta nga puna e pakualifikuar në sektorin informal, mbrojtja e pakët sociale, problemet e strehimit, etj.

Një grup tjetër faktorësh është arsimimi. Një pjesë e të rinjve emigrantë theksojnë se 'dëshirojnë të arsimohen' në vendin pritës ose të 'financojnë arsimimin e fëmijëve' të tyre. Kjo shpjegohet me cilësinë e ulët të arsimimit në Shqipëri. Krahas tyre, një pjesë e migrantëve (sidomos azil-kërkuesit) theksojnë si motiv shtytës edhe faktorët shëndetësorë.¹⁴

Ndërsa faktorët familjarë ku bëjnë pjesë bashkimi familjar, martesë ose largimi nga problemet familjare – të cilat kanë qenë karakteristikë e dekadës së dytë të migrimit – përfaqësojnë një përqindje të vogël.

Krahas faktorëve ekonomikë emigrantët theksojnë edhe faktorët që lidhen me mungesën e perspektivës ekonomike, sociale dhe politike në Shqipëri. Segmente të caktuara dhe më të kualifikuara të migrantëve, si studentët, profesionistët, etj. theksojnë mungesën e infrastrukturës fizike dhe sociale, perspektivën e zbehtë të karrierës, pakënaqësinë me kulturën politike të korrupsionit dhe nepotizmit, etj., dhe të një sensi të përgjithshëm se 'nuk ka të ardhme në Shqipëri'. Në mungesë të kësaj perspektive shumë të rinj zgjedhin rrugën e emigrimit.

PASOJAT E EMIGRIMIT

Pasoja e parë e emigrimit të lartë nga Shqipëria është zvogëlimi në terma absolute i popullsisë shqiptare, nga 3.2 milion në 1990 në më pak se 2.8 milion në 2024, duke kërcënuar kështu të ardhmen demografike dhe socio-ekonomike të vendit. Ky zvogëlim i popullsisë është rezultat i një përzierje demografike toksike të karakterizuar nga emigracioni i lartë, kthime në nivele të ulëta, norma në rënie të lindjeve (1.32 fëmijë për grua në 2020),¹⁵ dhe nga një emigrim potencial në nivele të larta (52 për qind për grupmoshën 18 deri 40 vjeç në 2018).¹⁶

Ndërkaq, ndërthurja e migrimit ndërkombëtar me migrimin e brendshëm ka sjellë edhe një zbalancim të popullsisë së Shqipërisë, duke e lënë vendin të ndarë midis polit të urbanizuar në mënyrë kaotike të rajonit të Tiranës dhe shpopullimit të zonave periferike.



13 Gëdeshi I., King R., (2022) Albanian Returned Asylum-Seekers: Failures, Successes and What Can Be Achieved in a Short Time. *Journal of Balkan and Near Eastern Studies* 24(3): 479-502; King R., Gëdeshi I., (2020). *New Trends in Potential Migration from Albania*. *Migration and Development* 9(2): 131-151.

14 Gëdeshi I., King R., (2022) Albanian Returned Asylum-Seekers: Failures, Successes and What Can Be Achieved in a Short Time. *Journal of Balkan and Near Eastern Studies* 24(3): 479-502

15 INSTAT (2022) *Albania in Figures 2021*. Tirana: INSTAT.

16 King R., Gëdeshi I., (2020). *New Trends in Potential Migration from Albania*. *Migration and Development* 9(2): 131-151.

Emigrimi i personave më të arsimuar dhe të kualifikuar (40 për qind e flukseve migratore për periudhën 2011-2019 ishin *brain drain* (largimit të trurit) ka çuar edhe në uljen e cilësisë së kapitalit human, çka ndikon negativisht në cilësinë e shërbimeve ndaj popullsisë, rritjen ekonomike, aftësinë konkurruese të vendit dhe thithjen e investimeve direkte të huaja. Nga ana tjetër Shqipëria po përballet me largimin masiv të personelit shëndetësor (sidomos të mjekëve), inxhinierëve, informaticienëve, etj., të cilët përbëjnë pjesën më të kualifikuar dhe më vitale të vendit. Kështu, një studim i fundit tregon se 52 për qind e mjekëve të grup-moshës 24-40 vjeç synojnë të emigrojnë nga Shqipëria. Ndërsa sipas raporteve të institucioneve ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore dhe OCDE, Shqipëria është një ndër vendet e para në botë për shkallën relative të migrimit të trurit.¹⁷

Popullsia e Shqipërisë është duke u plakur me shpejtësi. Sipas INSTAT-it mosha mesatare e popullsisë është rritur nga 27 vjeç në 1990 në 37.2 vjeç. Ndërsa pjesa e popullsisë 60 vjeç e sipër është dyfishuar gjatë 20 viteve të fundit, duke u rritur nga 11.2 për qind në 2001 në 22.6 për qind në 2022.¹⁸ Ndërkaq, kjo pjesë e popullsisë do të vazhdojë të rritet si rezultat i rritjes së jetëgjatësisë, uljes së fertilitetit, dhe vazhdimit të emigrimit të brezave të rinj. Kjo e streson sistemin e shëndetësisë dhe të pensioneve.

Nga emigrimi Shqipëria humbet fuqinë punëtore aq të nevojshme për rritjen e prodhimit. Aktualisht thuajse të gjithë sektorët ekonomikë kanë mungesa të fuqisë punëtore. Ky problem do të thellohet në të ardhmen. Sipas vlerësimeve të INSTAT-it, për shkak të emigrimit dhe uljes së fertilitetit, numri i personave në moshë ekonomikisht produktive pune 20-29 vjeç do të jetë rreth 33 për qind më pak në vitin 2031.

CILAT JANË DISA NGA MASAT QË DUHET TË NDËRMARRË SHTETI QË TË FRENOJË LARGIMIN E TË RINJVE DHE TË MUNDËSOJË GJITHASHTU RIKTHIMIN E TYRE?

Politikat duhet të synojnë përmirësimin dhe zgjerimin e strukturës së punësimit dhe mundësive të biznesit në Shqipëri. Është e rëndësishme **nxitja e skemave stimuluese të krijuara për të inkurajuar punësimin e të rinjve dhe përmirësimin e perspektivës së tyre. Për këtë qëllim duhet një program kombëtar, gjithëpërfshirës, i cili duhet të integrojë edhe zonat më të largëta. Punësimi duhet të jetë prioriteti kryesor qeverisë.**

Pavarësisht nga tipologjia e migrantëve të kthyer nga emigracioni, tendenca në rritje e azilkërkueseve dhe emigrimit masiv të moshat e reja, thekson **nevojën e masave për të adresuar sfidat e riintegritimit pas kthimit në vendin e origjinës. Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës për nevojat, kapacitetet dhe boshllëqet në njësitë administrative të prekura nga migracioni i kthimit dhe vlerësimi i potencialeve socioekonomike të të kthyerve është prioritar. Një aspekt i rëndësishëm që garanton riintegrim të qëndrueshëm të fëmijëve pas kthimit në Shqipëri është referimi dhe garantimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijën dhe familjen. Politikat dhe masat**

17 d'Aiglepierre R., David A., Levionnois Ch., Spielvogel G., Tuccio M. and Vickstrom E., (2020) A Global Profile of Emigrants to OECD Countries: Younger and More Skilled Migrants from More Diverse Countries. OECD Social, Employment and Migration Working Papers No. 239; World Bank., (2016) Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: The World Bank.

18 <http://www.instat.gov.al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>


për riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe kryesisht të rinjve azilkërkues duhet të përfshihen plotësisht në dokumente strategjike ndërsektorial dhe në planet vendore të veprimit për migracionin dhe përfshirjen sociale.¹⁹

Një faktor shtytës për emigrimin është edhe cilësia e ulët e arsimit. Rrjedhimisht duhet investuar më shumë për arsimin (si përqindje e GDP) dhe kërkimin shkencor. Aftësi profesionale të rinjve, në profesione që kërkohen nga tregu, duhet të rritet dhe një pjesë gjithnjë e më e madhe e tyre duhet të orientohen në shkollat e mesme profesionale. Krahas rritjes së investimeve për arsimin profesional duhet rritur edhe bashkëpunimi me shkollat analoge në vendet e BE për programet, specializimin e stafëve mësimore, praktikantët, etj.

Edhe universitetet duhen orientuar nga kërkesat e tregut të punës. Në këtë rast bashkëpunimi me universitetet e njohura në BE lidhur me programet e kurrikulat, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, intershipet dhe krijimin e rrjeteve akademike për kërkimin dhe trajnimin, duhet zgjeruar dhe forcuar. **Bashkëpunimi me diasporën shkencore shqiptare**, e integruar në universitetet dhe institucionet shkencore të BE dhe SHBA, do të ndihmonte për gjallërimin e jetës akademike dhe shkencore dhe rritjen e cilësisë në institucionet shqiptare.

Nëpërmjet fushatave kombëtare sensibilizuese duhet synuar frenimi i emigrimit të parregullt dhe kanalizimi i emigrimit nëpërmjet rrugëve formale. Në këtë rast do të kishte rëndësi **hartimi i marrëveshjeve me vendet pritëse në lidhje me emigrimin e rregulluar**. Qeveria shqiptare duhet të synojë emigrimin qarkullues, i cili mundëson kthimin e kapitaleve të fituara (financiare, humane dhe sociale) në vendlindje.

19 Xhaho, A. & Fetahu, E. (2021). [Return and Regret. Labour market reintegration Challenges of Albanian returnees](#). Tirana: IDM



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Institute for Democracy and Mediation
Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1, 1017
T: +355 4 240 0241 | C: +355 67 38 42 437
www.idmalbania.org